



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit -Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta-
Ministry of Culture, Youth & Sports

Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturore / Regionalni Centar za Kulturno Nasledje / Bölge
Kültürel Miras Merkezi / Regional Center for Cultural Heritage
Prizren

DATË/A:	14.08.2017
REFERENC-Ë:	Nr. 222/4
PËR/ZA/TO:	Drejtorja për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Samir Hoxha - Drejtor i QRTK-së Prizren
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendimi i Komisionit të IKMM-së Prishtinë

Po ju dërgojmë Vendimin e Komisionit të IKMM-së për Shqyrtimin dhe Vlerësimin e Kërkesave dhe Projekteve Restauruese-Konservuese të Trashëgimisë Kulturore nr.68/2017 të dt. 26.07.2017 për lëndën Drejtorja e Turizmit dhe Zhvill.Ekonomik (Osman,Avdullah,Hagji,Sinan,Musë Shatri dhe Musë Morina Nr. 04-353-66419 për restaurimin e mullirit në fshatin Dedaj, në ngastrën kadastrale Nr.00097-0 Z.K. Prizren.

Lëndës ia bashkangjesim kopjen e Vendimit.



416

10.08.17

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government
Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit / Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta /
Ministry of Culture, Youth and Sports

Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve
Kosovo Institute for the Protection of Monuments
Institut Kosova za zaštitu spomenika

Nr. 68/2017
Datë: 28.07.2017

U.D. Drejtori i Institutit të Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve z. Agim Gjerguri duke u mbështetur në nenin 3 (paragrafi 4, 8), nenin 4 (paragrafët 14, 17, 19 dhe 20) nenin 6 (paragrafët 3, 4, 5, 7 dhe 8), nenin 12 (paragrafi 2) të Ligjit Nr. 02/L – 88 për Trashëgiminë Kulturore, si dhe në zbatim të vendimit Ministrit të Kulturës, Rinisë dhe Sportit Nr. 18/2016 të datës 04.03.2016, mori këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet rekomandimi i Komisionit për Shqyrtimin dhe Vlerësimin e Kërkesave dhe Projekteve Restauruese – Konservuese të Trashëgimisë Kulturore të Institutit të Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve: "Miratimi i projektit ideor për intervenim në Monumentin e njohur si "Mulliri i Fshatit Dedaj".
2. Në bazë të rekomandimit dhe arsyetimit të Komisionit, kërkohet që gjatë zbatimit, të respektohet projekti zbatues i cili duhet të shqyrtohet dhe aprovohet në komision.
3. Zbatimi i punimeve sipas projektit të aprovuar bëhet nën mbikëqyrjen e zyrtarëve profesional nga Qendrat Rajonale për Trashëgimi Kulturore --Prizren.
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Mulliri i Rexhep Shatrit gjendet në fshatin Dedaj, në anën e majtë të kilometrit të shtatë të rrugës Prizren – Gjakovë. Është mulli me ujë, një strukturë tërësisht nga guri, edhe mbulesa është me rrasa gurësh. Enterieri i mullirit është mjaft i ruajtur dhe ka elemente origjinale të kohës. Gjendja në tërësi e objektit është e dobët, konstruksioni i kulmit është i kalbur, një pjesë e sipërfaqes së mbulesës (tjegullat) mungojnë. Në strukturën e mureve perimetrale prezantohen plasaritje të theksuara edhe strukturale. Në periudha të ndryshme kohore, mulliri ka pësuar edhe intervenime jo adekuate me elemente nga betoni. Komisioni pas shqyrtimit të hollësishëm të projektit aprovon intervenimet si adekuate dhe në harmoni me praktikën e mira të konservimit të monumenteve.

Komisioni për Shqyrtimin dhe Vlerësimin e Kërkesave dhe Projekteve Restauruese – Konservuese të Trashëgimisë Kulturore / IKMM, pas shqyrtimit të lëndës,

Rekomandon:

1. Të aprovohet projekti ideor për intervenim në Mullirin e fshatit Dedaj;
2. Njoftohet pala se Projektin Kryesor, të Projektit Ideor të miratuar nga Komisioni për Shqyrtimin dhe Vlerësimin e Kërkesave dhe Projekteve Restauruese – Konservuese të Trashëgimisë Kulturore / IKMM, duhet ta dorëzojë në Qendrën Rajonale për Trashëgimi Kulturore (QRTK) – Prizren për verifikim (të gjitha kopjet e projektit që i nevojiten palës). Dy kopje dixhitale dhe dy kopje fizike të projektit kryesor mbeten në QRTK – Prizren (një për QRTK – në dhe një për IKMM – në).
3. Intervenimet kryhen nën mbikëqyrjen e IKMM – së, përmes QRTK – Prizren.

Vendimi i dërgohet:

- Kabinetit të Ministrit;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- Komisionit për Shqyrtimin e Kërkesave dhe Projekteve IKMM;
- Departamentit të Trashëgimisë Kulturore;
- QRTK – së përkatëse;
- Komunës përkatëse;
- Departamentit Ligjor – MKRS;
- Zyrës së Drejtorit të IKMM – së;
- Arkivit të IKMM – së;
- Arkivit të MKRS – së;

